

VOCO GmbH  
Knowledge Communication Department  
Anton-Flettner-Str. 1-3  
27472 Cuxhaven  
Gjermania  
info@voco.de  
www.voco.dental



## VOCO Profluorid Varnish

### Përshkrimi i produktit:

VOCO Profluorid Varnish është një llak fluoruri për trajtimin e sipërfaqeve të smaltit dhe të dentinës. Është ideal për remineralizimin e përsheptuar dhe fluorizimin e së ashtuquajturës substancë të fortë të dhëmbit. Për shkak të matricës së tij natyrale të kolofonit, VOCO Profluorid Varnish ngjitet gjithashtu në sipërfaqet me lagështi dhe toleron mbetjet e lagështirës dhe të pështymës. Për më tepër, llakut i shtohet ksilitoli. Përveç vetive të tij për përmirësimin e shijes, konsiderohet se ksilitoli ka një efekt kariostatik.

### Përbërësit (ndër të tjera):

VOCO Profluorid Varnish përmban kolofon, aromatizues artificial, fluorur natriumi dhe ksilitol.  
1 ml VOCO Profluorid Varnish përmban 50 mg fluorur natriumi i barasvlershëm me 22,6 mg fluorur.

### Kundërindikimet:

- VOCO Profluorid Varnish përmban kolofon dhe aromatizues artificial. Duhet të shmangët përdorimi në rast hipersensitiviteti të ditur (alergji) ndaj përbërësve të VOCO Profluorid Varnish.
- VOCO Profluorid Varnish nuk duhet të përdoret te pacientët me inflamacione ulceroze të mishrave të dhëmbëve apo të mukozës orale.
- VOCO Profluorid Varnish nuk është menduar për trajtim sistematik.

### Grupi i synuar i pacientëve:

VOCO Profluorid Varnish mund të përdoret për të gjithë pacientët pa kufizime për sa i përket moshës apo gjinisë.

### Karakteristikat e produktit:

Karakteristikat e rendimentit të produktit përrupthen me kërkesat e përdorimit të synuar dhe standardet përkatëse të produktit.

### Përdorimi:

Përdorimi i VOCO Profluorid Varnish kryhet nga operatori i trajnuar profesionalisht në stomatologji.

Doza e rekomanduar:

- Trajtimi i pacientëve me dhëmbë primarë rreth 0,25 ml VOCO Profluorid Varnish
- Trajtimi i pacientëve me dhëmbë të kombinuar ose me dhëmbë permanentë rreth 0,40 ml VOCO Profluorid Varnish

Vendosni një shtresë të hollë të VOCO Profluorid Varnish në substancën e fortë të dhëmbit. Një shtresë e trashë do të shqitet lehtë dhe nuk ofron përfitime terapeutike.

### **Përgatitja:**

Pastrojeni mirë nga gurëzat zonën e trajtimit. Për të arritur një rezultat optimal, lëngje ose pështyma e tepërt duhet të hiqen nga sipërfaqja që do të trajtohet.

### **Vendosja:**

Vendoseni VOCO Profluorid Varnish njëtrajtshëm në mënyrë që e gjithë sipërfaqja të mbulohet me një shtresë të hollë. Lagni zonën e vendosjes (qoftë me shpëlarje të lehtë ose me pështymë natyrale) për të siguruar vendosjen e VOCO Profluorid Varnish.

### **Shënime/masat paraprake:**

- Pacientët duhet të këshillohen të shmangin ushqimet solide, alkoolin, pastrimin e dhëmbëve dhe përdorimin e fillit për 4 orë pas trajtimit.
- Rrallë është raportuar ënjtje edematoze, veçanërisht pas vendosjes në sipërfaqe më të mëdha.
- Me preparate të ngjashme është raportuar shumë rrallë marrja e frymës te fëmijët me astmë.
- Pacientët me sistem të ndjeshëm tretës mund të paraqesin të përziera pas një trajtimi të gjerë.
- Në rast hipersensitiviteti: Hiqeni llakun me një furçë të butë dhëmbësh dhe fill dentar, pastaj shpëlajeni me ujë të ngrohtë.
- Ditën e trajtimit, mos përdorni më tej përgatitje që përmbajnë fluorur.
- Pezulloni përdorimin e tabletave të fluorurit për disa ditë pas trajtimit me VOCO Profluorid Varnish.
- Mos e gëlltisni llakun.

### **Ruajtja:**

Të ruhet në 4°C–23°C. Mos e përdorni pas datës së skadencës.

### **Hedhja:**

Hedhja e produktit të kryhet në përputhje me rregulloret vendore.

